



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.511/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.511/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 fletëvotim në Vendvotimin 2533D/02D, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar, i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 24.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.511/2019 nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendon se me datë 23.11.2019, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë rinumërimit të votave në kutin e vendvotimit 2533D/02D, vëzhguesi i tyre ka vërejtur se 1 fletëvotim është shpallur i vlefshëm pa të drejtë nga zyrtarët e QNR-së.

Parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, sipas shtojcës nr.8 (Mostër e fletëvotimit të Pavlefshëm), ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm për arsye se është votuar në dy hapësira të subjekteve politike me numër 126 dhe një “llojë rrethi” poashtu i vendosur në numrin e subjektit politik 126.

Në vazhdim të ankesës theksojnë se votimi apo shkrimi i dytë, vërehet kur votuesi po ashtu shkruan numra si: 10 104 edhe në hapësirën përkrah subjektit tjetër politik me numër 127, dhe sipas tyre në këtë rast nuk ka qëllim të qartë të votuesit dhe kjo bie në kundërshtim me Doracakun-shtojca nr.8.

Parashtruesi i ankesës, ankesës ia ka bashkangjitur në cilësinë e provës materiale, mostrën e fletëvotimit të pavlefshëm sipas doracakut të KQZ-së shtojca 8 dhe kopja e fletëvotimit nr.2533D/02D.

Kërkojnë nga PZAP-i që ankesa e tyre të aprovohet në tërësi, këtë fletëvotim nga vendvotimi nr.2533D/02D ta shpallë të pavlefshëm dhe ta obligoj KQZ-QNR që këtë ta largoj nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar.

Në përgjigje në ankesë të datës 24.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në rastin e vendotimi 2533D/02D fletëvotimi është shpallur i vlefshëm për arsye se tek Subjekti 126 votuesi ka shenjuar me "TIK" në katrorin e Subjektit e cila e bën të qartë qëllimin e votuesit ndërsa numrat tek kolona e Subjektit 127 në bazë të doracakut nuk e prish qëllimin e votuesit

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit 2533D/02D, nga ana e QNR-së, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim, në të cilin votuesi përveç se ka votuar për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje i njëjti ka shënuar numra tjerë edhe përkrah hapsirave të dy subjekteve politike me numër 126, Lëvizja Vetëvendosje dhe hapësirën e subjektit me numër 127, Kosova Turk Demokratik Partisi(KDTP).

Kolaicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 4 lidhur me ndryshimin e nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm sepse bie në kundërshtim me Kodin e Etikës për Zgjedhje dhe mostrën 7 të Doracakut të KQZ-së.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se një fletëvotim i gjetur në kutinë e votimit 2533D/02D, pa të drejtë është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbushë asnjërin kriter të vlefshmërisë, andaj i njëjti duhet të llogaritet si i pavlefshëm dhe duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar më datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Fletëvotimi i shpallur i pa vlefshëm, të largohet nga rezultati i publikuar përfundimtar i datës: 07.11.2019, te cilin fletëvotimin e gjeni te bashkangjitur me këtë vendim.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja
Anr. 511/2019 më datë 24.11.2019**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



ZAJEDNITI
PREI

REPUBLIKES SE KOSOVES 2019
PUBLIKE KOSOVO 2019

1 Shqiptari VETEM NJE subjekt politik
Ozniecie SAMO JEDAN politicki subjekt

2 Shqiptari ME SE SHQIPTARE shtetsh
Ozniecie MALINJE PHT shtetsh

111. PARTIA LIBERALE EGIPTIANE - PLE

112. POK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES - PDK

113. PARTIA E ASHKALINJEVER PER INTEGRIMI - PAI

114. STRANKA DEMOKRATISKE AKCIE - SDA

115. PARTIA KOSOVSQIH SRBA - PKS

116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALINJE TE KOSOVES - PDAK

117. POKRET ZA GORA - PG

118. NOVA DEMOKRATISKA STRANKA - NDS

119. AAK - PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË

120. SLOBODA

121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SIS

122. NISKA SOCIAL DEMOKRATIE ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISE

123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIA - JGP

124. KOALICIA VAKAT

125. FIJALA

126. LEVIZJA VETEENDOSJEE 112, 121

127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KOTP 30 104

128. PARTIA ROMIE E BASHKUAR E KOSOVES - PREBK

129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVES - PEK

130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP

131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVES - IRDK

132. ESMIR KASI

133. GRADANSKA INICIATIVA GORE - GIG

134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES - LDK

135. SRPSKA LISTA

1	2	3	4
5	6	7	8
9	10	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		